



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2314/2 Prot.

Vlorë më, 28.08 2026

VENDIM

Nr. 148, datë 28.08.2026

PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË ANËTARËVE TË GRUPEVE TË PUNËS PËR ORËT E PUNËS TË REALIZUARA NË KUADËR TË SHKRIMIT/HARTIMIT TË PROJEKT-PROPOZIMEVE TË APLIKUARA GJATË VITIT AKADEMIK 2024–2025, SIPAS SHKRESËS NR. 1967/3 PROT., DATË 07.08.2026 TË ADMINISTRATORIT TË UV-SË

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, gërma ë, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026"; Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Rregullores Financiare të UV-së; Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 10, datë 12.02.2026 "Për miratimin e Buxhetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Vendimit të Bordit të Administrimit nr.97, datë 18.12.2025 për vitin 2026", si dhe referuar propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr. **1967/3 prot, datë 07.08.2026**, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 28.08.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e anëtarëve të grupeve të punës për orët e punës, të realizuara në kuadër të shkrimit/hartimit të projekt-propozimeve të aplikuara gjatë vitit akademik 2024–2025, sipas shkresës nr. **1967/3 prot, datë 07.08.2026** të Administratorit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UV- së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj

Elmira Kushta

Ledina Mançka

Orkida Hasani

KRYETAR

Saniela Xhaferi

